



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.897/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Banka Tregtare –Dega ne Kosovë, me seli ne rr.”Ukshin Hoti” nr.29 Prishtinë, ndaj debitorit 1. Kompania NTSH “Euro Trans” –kredi marrës, me nr. Biznesi 70457023 e përfaqësuar nga pronari Q.P. me nr. Personal .... me adresë ne fshatin .... pn, 2. Q.P. me nr. Personal .... me adresë ne fshatin .... pn Rahovec, 3. H.P. me nr. Personal .... me adresë ne fshatin .... pn, Rahovec, 4. E.P. me nr. Personal .... me adresë ne fshatin .... pn Rahovec, te përfaqësuar me autorizim nga Teki Bokshi avokat ne Gjakovë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, te ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr.531/23 dt.29.12.2023, me datën 29.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit 1. Kompania NTSH “Euro Trans” –kredi marrës, me nr. Biznesi 70457023 e përfaqësuar nga pronari Q.P. me nr. Personal .... me adresë ne fshatin .... pn, 2. Q.P. me nr. Personal .... me adresë ne fshatin .... pn Rahovec, 3. H.P. me nr. Personal .... me adresë ne fshatin .... pn, Rahovec, 4. E.P. me nr. Personal .... me adresë ne fshatin .... pn Rahovec, të ushtruar përmes përfaqësuesit te autorizuar Teki Bokshi avokat ne Gjakovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr.531/23 dt.29.12.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.531/23 dt.29.12.2023, ne pjesën e I te dispozitivit te aktvendimit ka aprovuar pjesërisht si te bazuar prapësimin e debitorit, ashtu qe ka shfuqizuar piken V te Urdhrit përmbarimor P.nr.302/17 dt.16.10.2017, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha ndërsa ne pjesën II te dispozitivit te aktvendimit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit, ashtu qe ka lenë ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.302/17 dt.16.10.2017, te lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha, për pikat tjera te urdhrit përmbarimor përjashtimisht pikës V, e shfuqizuar si ne piken e I te këtij dispozitivi.

Kundër këtij aktvendimi përkatësisht pikës II te dispozitivit, ka ushtruar ankesë debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore –nenit 17 të LPP lidhur me nenin 181 pika a) e LPK, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, neni 17 të LPP lidhur me nenin 181 pika b) e LPK dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale të LPP lidhur me nenin 181 pika c) e LPK, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar ashtu që pika e II e dispozitivit të këtij aktvendimi të priset dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rishqyrtim dhe rivendosje ose të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të anulohet Konkluzioni i Përbaruesit Privat Rushit Hoxha P.nr.302/17 dt.16.10.2017 si i pabazuar dhe joligjor.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Banka Tregtare –Dega në Kosovë, me seli në rr.”Ukshin Hoti” nr.29 Prishtinë, me datë 16.10.2017, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit 1. Kompania NTSH “Euro Trans” –kredi marrës, me nr. Biznesi 70457023 e përfaqësuar nga pronari Q.P. me nr. Personal .... me adresë në fshatin .... pn, 2. Q.P. me nr. Personal .... me adresë në fshatin .... pn Rahovec, 3. H.P. me nr. Personal .... me adresë në fshatin .... pn, Rahovec, 4. E.P. me nr. Personal .... me adresë në fshatin .... pn Rahovec, në bazë të dokumentit përbarimor Kontrata e kredisë bankare nr.4617/12 dt.26.02.2012, Kontrata e kredisë bankare nr.3565/11 dtr.17.06.2011, Kontrata e kredisë bankare nr., 4213/11 dt.22.12.2011, Aneksi i Ri programimit, Kontrata mbi Hipotekën nr.4617/12 dt.26.06.2012, Aktvendim mbi regjistrimin e Hipotekës nr.prot.275 lëshuar nga Zyra Komunale e Kadastrit në Rahovec. Përbaruesi Privat Rushit Hoxha, duke vepruar sipas propozimit për përbarim ka lejuar përbarimin me urdhrin përbarimor P.nr.302/2017 dt.16.10.2017, përmes së cilit ka obliguar debitorin që kreditorit në emër të detyrimit nga dokumentet përbarimore ti paguaj prej 87,780.86 euro, me normat e interesit të rregullt.

Ndaj urdhrit përbarimor, prapësim ka ushtruar debitori me datë 06.11.2017, përmes së cilit kundërshton urdhrin përbarimor përkitazi lartësisë së kërkesës përbarimore dhe propozon që gjykata ta aprovoj këtë prapësim ndërsa urdhrin përbarimor dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përbarimore të lihen jashtë fuqie ligjore.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 09.11.2017 me arsyetimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori në prapësim, prapësimi nuk është në pajtim me nenin 69 pika 5 e LPP dhe se pretendimet e debitorëve nuk bazohen në asnjë nga pikat e nenit 71 të

LPP, ashtu qe propozon qe gjykata ta hedhe poshtë prapësimin e debitorit dhe ta lë ne fuqi urdhrin përmbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë, pas shqyrtimit te prapësimit dhe përgjigjes ne prapsim ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.531/23 dt.29.12.2023 i përmirësuar me aktvendimin KPPP.nr. 531/23 dt.25.01.2024, duke vendos si ne dispozitiv. Gjykata arsyeton se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, i referohet dispozitave ligjore nga neni 21, 22 par.1.7 e LPP nenit 27 par.1 te LPP dhe nenit 38 par.1 te LPP, dhe gjenë se propozimi për përmbarim lidhur me Marrëveshjen e Pengut përmban te meta sepse dokumenti nuk është dorëzuar, Gjykata i referohet edhe nenit 43 par.4 mbi bazën e te cilit anulon pjesërisht urdhrin përmbarimor ne kuptim te këtyre te metave, po ashtu vlerëson se dokumentet tjera mbi bazën e te cilave është lejuar përmbarimi kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 par.1.7 dhe nenit 27 te LPP për te qenë te pranueshme dhe te përshtatshme për përmbarim, duke arsyetuar me tutje edhe ne pajtim me nenin 71 , 21 par.2 te ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimorë e ne pajtim me nenin 220 te ligjit bazim ku par.1 shtohet paragraf i ri. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në prapësimin e debitorit nuk janë paraqitur asnjë nga shkaqet të cilat janë parapara në nenin 71 të LPP-së, që do të pengonin përmbarimin e lejuar duke vendosur si ne dispozitiv.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj vendimin e gjykatës se shkalles se parë lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkalles se Dytë, bazuar ne shkresat e lendes vlerëson se Gjykata e shkalles se parë ka pranuar si te drejte përfundimin juridik te gjykatës se shkalles e parë, se mungon Kontrata mbi Pengun mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi edhe pse ne shkresa te lendes gjendet Konfirmimi i regjistrimit te pengut me nr.R-20161031-324 nga data 31.10.2016 deri me 31.10.2021. Sa i përket dokumenteve tjera mbi bazën e te cilave është lejuar urdhri përmbarimor si Kontrata e kredisë bankare nr.4617/12 dt.26.02.2012, Kontrata e kredisë bankare nr.3565/11 dtr.17.06.2011, Kontrata e kredisë bankare nr., 4213/11 dt.22.12.2011, Aneks i Ri programimit, Kontrata mbi Hipotekën nr.4617/12 dt.26.06.2012, Aktvendim mbi regjistrimin e Hipotekës nr.prot.275 lëshuar nga Zyra Komunale e Kadastrit ne Rahovec, edhe kjo gjykatë vlerëson se te njëjtat paraqesin titull ekzekutiv, pra ashtu siç parasheh neni 36 dhe nenin 27 par.1 te LPP sepse propozimit për përmbarim i janë bashkangjitur ne kopje te vërtetuara –noterizuara, ashtu siç parashohin këto dispozita ligjore nga neni, vlerësuar këtu faktin se Kontrata për Hipotekën është e regjistruar nga zyra përkatëse e regjistrimit, me çka janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara

ligjore për lejimin e përmbarimit dhe në të njëjtën kohë edhe për refuzimin pjesërisht të prapësimit të debitorit.

Kjo gjykatë i analizoi pretendimet ankimore të palës debitore se aktvendimi i atakuar përmban shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale por vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë, ashtu që i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërtetoi.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.897/24, me datë 29.11.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova